REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LUSHNJE

Nr. 6963 Prot.

Lushnje, më 14/07/2026

RELACION
KËSHILLIT BASHKIAK
KËTU

PËR NJË SHTESË NË VKB-NË NR 03 DATË 22/01/ 2026 "PËR MIRATIMIN E LISTËS SË SUBVENCIONIT TË QIRASË PËR FAMILJET E PASTREHA, QË BANOJNË ME QIRA NË TREGUN E LIRË DHE NUK KANË TË ARDHURA TË MJAFTUESHME PËR TA PËRBALLUAR VETË GJITHË VLERËN E QIRASË"

Të nderuar këshilltarë!

Në zbatim të nenit 24, nenit 54 të ligjit Nr: 139/2015 datë 17.12.2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", ligjit nr.22/2018 datë 03.05.2018 "Për strehimin social"i ndryshuar neni 20, 25, 26, 27, 33,34,42,dhe të VKM Nr.384 datë 12.06.2019 "Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të proçedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore", VKM Nr.362, datë 29.05.2019 "Për kriteret e dhënies së subvencionit të qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionimin e qirasë në tregun e lirë, nëpërmjet buxhetit të shtetit, dhe mënyrën e llogaritjes së tij", sipas VKB Nr: 119,datë;23.12.2025 ,të VKM Nr.459 datë 3.7.2019 "Për rregullat për administrimin e kërkesave të njësive të vetëqeverisjes vendore për fonde nga buxheti i shtetit për subvencionimin e qirasë dhe uzufruktit, mënyrën e financimit të subvencionit, monitorimin dhe bashkëpunimin ndërmjet njësive të vetëqeverisjes vendore dhe ministrisë përgjegjëse për strehimin dhe të VKB Nr.109 datë 21.11.2025 "Mbi miratimin e sistemit të pikëzimit për programin "Subvencionimi i Qirasë " është bërë vlerësimi i kërkesave, duke ndjekur proçedurat si vijon:

1. Paraqitja e kërkesës dhe e dokumentacionit nga personat e interesuar pranë zyrës se informacionit duke kryer aplikimin në sistemin online e.albania.
2. Shqyrtimi i kërkesës dhe dokumentacionit merret nga specialistia e strehimit, që kontakton cdo qytetar/e nëse ka mungesa, apo pasaktësi në dokumentacion përkatës.
3. Verifikimi në çdo banesë për adresën dhe kushtet e banimit sipas kontratës së qirasë, nga administratori i njësisë administrative në bashkëpunim me Drejtorinë e Shërbimit Social ku banon kërkuesi/e.

Përzgjedhja e familjeve përfituese bëhet mbi bazën e sistemit të pikëzimit,pasi kanë kaluar fazën e komisionit. Përparësi në subvencionimin e qirasë sipas sistemit të pikëzimit kanë, por pa u kufizuar në to, kategoritë e mëposhtme : *Kushtet e strehimit në baze të të cilave percaktohen me përparësi:*

i)Familja nuk disponon banesë në pronësi.
ii)Familja banon në banesa që paraqisin rrezik shëmbjeje.
iii)Familja banon në banesa te mbipopulluara,sipas përcaktimeve dhe normave ne fuqi.
iv)Familjet kanë mbetur ose rrezikojnë të mbeten të pa streha si rezultat i fatkeqësive natyrore.
v)Familjet ose individët që humbasin banesën e tyre, si pasojë e zhvendosjes ose zbatimit të një vendimi gjyqësor.
vi)Familjet banojnë në banesa që prishen ose përjashtohen nga porçesi i legalizimit, si rezultat i investimeve publike.

Kushtet sociale, në bazë të të cilave përcaktohen me përparësi:

i)Personat me aftësi të kufizuar në përputhje me përcaktimet e bëra me vendimin të Këshillit të Ministrave.
ii)Individë me statusin e jetimit që nga çasti i daljes nga qendrat e përkujdesit shoqëror e deri në moshën 30 vjeç.
iii)Familjet e mbetura të pastrehë për shkak të lirimit të banesave të ish-pronarëve.
iv)Emigrantët e rikthyer, puntorët emigrant, azilkërkues,refugjatë apo persona me mbrojtje plotësuese.
v)Familjet e policëve të rënë në detyrë.
vi)Punonjës i reparteve RENEA.
vii)Punonjës i repartit të ndërhyrjes së shpejtë FNSH.
viii)Punonjësit e shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi.
viiii)Viktimë e trafikimit ose viktimë e mundshme të trafikimit.
x)Anëtarë të komunitetit Rom / Egjiptian.
xi)I mitur në konflikt me ligjin sipas parashikimeve të Kodit të Drejtësisë Penale për të mitur , pas ekzekutimit të dënimit.
xii)Vajzë nënë.
xiii)Individë që i përket komunitetit LGBTI, i cili ka një vendim të organit kompetent si viktimë e oreintimit seksual ose identitetit gjinor.

Kushtet familjare në bazë të të cilave përcaktohen me përparësi:

i)Familjet një prindërore që kanë në ngarkim fëmijë, ku përfshihen edhe vajzat nëna.
ii)Të moshuarit, që kanë mbushur moshën e pensionit dhe që nuk përzgjidhen për t'u strehuar në institucionet publike të përkujdesjes shoqërore.
iii)Familjet me më shumë se katër fëmijë.
iv)Familjet e reja.
v)Të rinjtë që në momentin e paraqitjes së kërkesës kanë një moshë jo më të madhë se 40 vjeç.

Sa më lart, i propozojmë Këshillit të Bashkisë të miratojë këtë projekt-vendim, për t'u ardhur në ndihmë familjeve të pastreha, që banojnë me qira në tregun e lirë dhe nuk mund të përballojnë me të ardhurat e tyre vlerat e qirasë mujore, ndërkaq mbartin një sërë problematikash familjare, shëndetësore dhe sociale.

Drejtoria Shërbimit Social
Anila Cela

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK LUSHNJE

Nr.6862 Prot.

Lushnje, më 14/07/2026

PROJEKT - VENDIM

NR. 62 DATË 14/07/2026

PËR NJË SHTESË NË VKB-NË NR 03 DATË 22/01/ 2026 "PËR MIRATIMIN E LISTËS SË SUBVENCIONIT TË QIRASË PËR FAMILJET E PASTREHA, QË BANOJNË ME QIRA NË TREGUN E LIRË DHE NUK KANË TË ARDHURA TË MJAFTUESHME PËR TA PËRBALLUAR VETË GJITHË VLERËN E QIRASË"

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e datës ___/___/2026 pasi analizoi relacionin e paraqitur nga zyra e Strehimi dhe në zbatim të nenit 24, nenit 54 të ligjit Nr: 139/2015 datë 17.12.2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", ligjit nr.22/2018 datë 03.05.2018 "Për strehimin social"i ndryshuar ,neni 20, 25, 26, 27, 29,33,34,42 dhe të VKM Nr.384 datë 12.06.2019 "Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të proçedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore", VKM Nr.362, datë 29.05.2019 "Për kriteret e dhënies së subvencionit të qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionimin e qirasë në tregun e lirë, nëpërmjet buxhetit të shtetit, dhe mënyrën e llogaritjes së tij", VKB Nr:119 datë:23.12.2025, të VKM Nr.459 datë 3.7.2019 "Për rregullat për administrimin e kërkesave të njësive të vetëqeverisjes vendore për fonde nga buxheti i shtetit për subvencionimin e qirasë dhe uzufruktit, mënyrën e financimit të subvencionit, monitorimin dhe bashkëpunimin ndërmjet njësive të vetëqeverisjes vendore dhe ministrisë përgjegjëse për strehimin" dhe të VKB Nr.109 datë 21.11.2025 "Mbi miratimin e sistemit të pikëzimit për programin "Subvencionimi i Qirasë "Këshilli Bashkiak:

PROPOZOJMË :

1. Të miratojë listën e subvencionimit të qirasë për familjet e pastreha që banojnë me qira në tregun e lirë dhe nuk kan të ardhura të mjaftueshme për ta përballuar vetë gjithë vleren e qirasë për periudhën Korrik- Dhjetor 2026, sipas tabelës bashkëngjitur.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria Shërbimit Social dhe Drejtoria e Financë-Buxhetit.
3. Vendimi hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.

Drejtoria Shërbimit Social

Anila Cela

Drejtoria Juridike

Bedri Hida

KRYETARI I BASHKISË

Eriselda Sefa

Nr.	Emër Atësi Mbiemër	Kategoria sipas nenit 16të ligjit nr. 22/2018	Adresa	Përberja familjare	Struktura e apartamentit	Qiraja mes. e apart. në treg per strukturen qe i takon familjes	Të ardhurat familjare mujore	Subvencioni në muaj që mbulohet nga bashkia
a	b	c	d	e	f	h	i	n
1	Rezart Agim Murati	Familje e re	"Kongresi"	5	2+1	18,000	60,000	9,000
2	Shefikatë Hamit Elezi	Divorcuar	"Njesia Administrative Fiershegan"	2	1+1	16,000	56,000	8,000

Drejtoria e Shërbimit Social

Anila Cela